

**MBI**  
**AUDITIMIN FINANCIAR TË USHTRUAR NË**  
**DREJTORINË E SHËRBIMIT SPITALOR KRUJË**

Raporti Përfundimtar i Auditimit Financiar të kryer në **Drejtoria e Shërbimit Spitalor Krujë**, me objekt: *“Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare në Drejtoria e Shërbimit Spitalor, Krujë, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2012 dhe vetëm blerjet e vogla për periudhën 2009-2010”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 31.12.2012 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 169, datë 30.12.2013.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 732/15, datë 31.12.2013, i ka rekomanduar z. Durim Herri, Drejtor i Shërbimit Spitalor Krujë, zbatimin e masave të mëposhtme:

#### **A. PËRMIRËSIM LIGJOR**

Bazuar në ligjin nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, i rekomandojmë Ministrisë së Shëndetësisë të ndërmarë nismën për rishikimin e kuadrit të nevojshëm ligjor të emërimit dhe largimit të punonjësve nga puna dhe shfuqizimin e VKM nr. 397, datë 03.09.1992 *“Për emërtesat dhe procedurat e lëvizjes dhe të emërimit të drejtuesve të kuadrit të lartë dhe të personelit tjetër në sektorin shëndetësor”* dhe Udhëzimit të Ministrisë së Shëndetësisë dalë në zbatim të tij nr. 37, datë 10.03.1994 *“Për detyrat dhe funksionimin e sektorit të personelit pranë DSH Publik të Rrethit”*, pasi ky akt nuk përmend konkurrimin e hapur.

#### **B. MASA ORGANIZATIVE:**

**B.I** Ministria e Shëndetësisë, në bashkëpunim me hallkat e nevojshme të hartojë rregulloren e funksionimit të spitaleve publike.

Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me Ministrinë e Financave, të plotësojë detyrimin ligjor duke përcaktuar faturën dhe dokumentacionin që shoqëron shitjen e barnave, lidhur me elementët e nevojshëm si, emri i plotë i dozës barit, seria e barit, afati i skadencës, emrin e fabrikuesit, apo importuesit, etj.

#### **B.II. Për Drejtoria e Shërbimit Spitalor Krujë (DSHS).**

1. DSHS Krujë, të marrë masa për krijimin e regjistrit të aktiveve të qëndrueshme, në të cilin të pasqyrohen të dhënat e nevojshme si, data e hyrjes, vlera e blerjes, vlera e shpenzimeve të mirëmbajtjes, amortizimi i akumuluar etj.

2. DSHS Krujë, të hap dhe të azhurnojë rregullisht kartelat financiare për pasqyrimin e lëvizjeve të barnave në sasi dhe vlerë, si dhe kryerjen e rakordimeve periodike me kartelat kontabël të mbajtura nga Sektori i Financës.

3. DSHS Krujë të marrë masa për sekretimin e regjistrave që përdoren aktualisht për dokumentimin e të ardhurave dytësore, duke i plotësuar ata me të gjitha ekstremitetet e nevojshme.

4. DSHS Krujë, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, të parashikojë në programimin e buxhetit pasardhës likuidimin gradual të faturave për blerje barnash të trashëguara prej vitit 2004 dhe të palikuiduara për 20 subjekte në shumën 8,768,582 lekë.

5. DSHS Krujë, të marrë masa duke ngritur grupe pune me specialistë infermierë, mjekë, etj, me afate konkrete, për përpunimin dhe klasifikimin e dokumentacionit të mbledhur prej vitesh, me qëllim vënien në efikasitet dhe funksionimin e Kartotekës të Spitalit.

### **C. MASA SHPËRBLIM DËMI**

Mbështetur në ligjin nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë”, nenet 105-109 dhe pikës 93 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” Kap IV, nga ana e titullarit të njësisë publike të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në **vlerën 3,078,826 lekë**, si më poshtë:

1. Vlera **818,856 lekë**, sa paguar padrejtësisht për “Shpërblime për festën e 8 Marsit”, në kundërshtim me VKM nr. 369, datë 13.06.2007 “Për fondin e veçantë në institucionet buxhetore” dhe nr. 1151, datë 25.11.2009 “Për krijimin dhe përdorimin e fondit të veçantë” pika 2/d.
2. Vlera **1,549,890 lekë**, paguar si shpërblim punonjësve “Për punë të mirë”, detyrim për t’u kthyer në buxhetin e kësaj njësie shpenzuese në përputhje me pikën 1/b të VKM nr. 591, datë 23.07.2010 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”.
3. Vlera **484,080 lekë**, përfituar nga z. L.V. ish/nëndrejtor ekonomik, për shkak të pagesës në mënyrë të padrejtë me diplomën e arsimit të lartë, duke qenë me arsim të mesëm për periudhën nga muaji qershor të vitit 2006 deri në shtator të vitit 2010.
4. Vlera **118,000 lekë**, paguar padrejtësisht 10 punonjës të administratës të Spitalit, Krujë për vitin 2010 “Shpenzime për udhëtim e dieta”, në kundërshtim me VKM nr. 591, datë 23.07.2010 “Për disiplinimin e përdorimit të fondeve buxhetore”.
5. Vlera **108,000 lekë** për shkak të blerjes të Barit Cefazolinë, me çmimet më të lartë se tregu, brenda të njëjtit muaj; diferencave të çmimeve në blerjen e Shiringave, brenda muajit apo vitit në të njëjtin operator me çmime të ndryshme të pa argumentuara; si dhe për pagesën e specialistëve të jashtëm të punësuar me kontratë.

### **Ç. MASA DISIPLINORE**

**Ç.1.** Mbështetur në nenin 144 të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenin 19 të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, dhe nenit 10 “Masa disiplinore” të kontratës individuale të punës, është rekomanduar Drejtori i Shërbimit Spitalor Krujë dhe Ministri i Shëndetësisë, që të vendosë për fillimin e procedurave për **“Zgjidhje të menjëhershme të kontratës së punës”**, për;

1. **L.V.**, aktualisht me detyrë nëndrejtor ekonomik për shkeljet e konstatuara për periudhën 2009-2012, pasi:
  - a) Ka kryer blerje në vlera të vogla për periudhën e viteve 2009-2010 për 360 medikamente mjekësore në vlerën 7,776,606 lekë, ndërkohë që nuk ishin parashikuar nevojat të shoqëruara me listat për llojet e medikamenteve apo grup mallrave dhe nuk ishte dërguar për botim në APP.
  - b) Ka kryer blerje në vlera të vogla në kapërcim të shumës kufi për periudhën e 2 viteve 2009-2010, për 360 medikamente mjekësore në vlerën 7,776,606 lekë.
  - c) Nuk ka argumentuar fondin limit, për blerjet e vogla.
  - ç) Në komisionin e blerjeve në vlera të vogla, të medikamenteve të mjekimit nuk është caktuar specialist i fushës, mjek, apo infermier.
  - d) Nuk ka ngritur komision dhe nuk janë hartuar procesverbalet e marrjes në dorëzim të medikamenteve mjekësore, për vitet 2009-2010 për 360 barna në vlerën prej 7,776,606 lekë. Blerja e tyre është bërë pa u shoqëruar me dokumentin përkatës, lidhur me serinë e barit, përmasat, paketimin, përshkrimin e plotë të barit, data e skadencës, fabrika prodhuese, etj. Në 200 barna në procesverbalet e blerjes dhe fletë hyrjet e farmacisë, nuk është shënuar formëdoza e plotë, duke lënë shteg për abuzime, pasi barnat me formëdoza të ndryshme, origjinë dhe prodhues të ndryshëm kanë çmime të ndryshme.
  - dh) Për blerjen e medikamenteve, nga ana e komisionit nuk është bërë ndarja e marzhit, pasi nga operatorët ekonomikë nuk janë paraqitur dokumentacionet e regjistrimit të tyre, për të përcaktuar statusin e operatorëve në cilësinë e importuesit apo shpërndarësit.

-Ka lejuar të kryhej pagesë e kundërligjshme për veten e tij, në cilësinë e nëndrejtorit të Spitalit Krujë, për një periudhë prej 23 muajsh, duke përlogaritur padrejtësisht pagën me nivelin e arsimit të lartë, ndërkohë që nuk ishte diplomuar.

**Ç. 2.** Mbështetur në nenin 37, të ligjit nr. 7691, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar dhe nenit 10 “Masa disiplinore” të kontratës individuale të punës, i rekomandojmë Drejtorit të Shërbimit Shëndetësor, fillimin e procedurave për dhënien e masës dënim me gjobë në vlerën prej 156,852 lekë, 8 punonjësve, si më poshtë:

**1. R.L.** ish-drejtor i Shërbimit Spitalor Krujë, aktualisht mjek gjinekolog, gjobë në masën e 15 ditëve të punës ose 29,000 lekë, për shkeljet e mëposhtme:

a) Ka lejuar të kryhen blerje në vlera të vogla për periudhën 2009-2010 për 360 medikamente mjekësore në vlerën 7,776,606 lekë, ndërkohë që nuk ishin parashikuar nevojat të shoqëruara me llojet e medikamenteve apo grup mallrash dhe nuk ishte dërguar për botim në APP.

b) Nuk ka argumentuar fondin limit, për blerjet e vogla.

c) Në komisionin e blerjeve në vlera të vogla, të medikamenteve të mjekimit nuk ka caktuar specialist të fushës, mjek, apo infermier.

ç) Nuk ka ngritur komision për marrjen në dorëzim dhe kolaudimin e medikamenteve.

d) Nga mos kontrolli i veprimtarisë së komisionit të blerjeve në vlera të vogla, ka lejuar blerjen e barnave me çmime më ta larta se tregu, si dhe ndryshime të shpeshta dhe të paargumentuara të çmimeve.

dh) I ka propozuar Ministrinë të Shëndetësisë emërimin e z. L.V. në detyrën e nëndrejtorit ekonomik të Spitalit Krujë, pa përfunduar arsimin e lartë, duke e paguar për një periudhë prej 23 mujore dhe krijuar një dëm ekonomik për vlerën 484,080 lekë.

**2. H.M.** me detyrë përgjegjëse e sektorit të financës, gjobë në masën e 5 ditëve të punës ose 13,738 lekë, për shkeljet e mëposhtme:

a) Ka lejuar të jepen shpërblime në shumën 818,856 lekë për vitin 2009 dhe 2010, për shpërblimin e punonjësve femra për festat e 8 marsit, në bazë të urdhrave përkatës të titullarit të institucionit me burim financimi fondin e veçantë.

b) Nuk ka kryer ndalesat për kthimin në buxhetin e institucionit të shumave të punonjësve që kanë përfituar në total 1,519,740 lekë shpërblime “për punë të mirë” nga fondin e veçantë.

c) Nuk ka kontrolluar në magazinë-farmacë nëse janë hapur dhe azhurnuar rregullisht kartelat për medikamentet e furnizuara për periudhën 2009-2011, duke lejuar mungesën e plotë të kartelave për çdo medikament, si dhe mos kryerjen e rakordimeve periodike të tyre me kartelat kontabël.

**3. N.K.** me detyrë ndihmës farmacistë, gjobë në masën e 5 ditëve të punës ose 9,284 lekë, për shkeljet e mëposhtme:

a) Ka kryer pranimin e medikamenteve, duke i bërë hyrje në Farmaci pa u shoqëruar me dokumentin që përshkruajnë të dhënat kryesore për; formëdazat e plota sipas njësive dhe standardeve ndërkombëtare, serine e prodhimit të barit, prodhuesi, origjina, paketimi, etj.

b) Nuk ka kontrolluar në magazinë-farmacë nëse janë hapur dhe azhurnuar rregullisht kartelat për medikamentet e furnizuara për periudhën 2009-2011, duke lejuar mungesën e plotë të kartelave për çdo medikament, si dhe mos kryerjen e rakordimeve periodike të tyre me kartelat kontabël.

**4. A.P.** Jurist, gjobë në masën e 15 ditëve të punës, ose 21,775 lekë.

**5. A.D.** teknik ndërtimi në Spitalin Krujë, gjobë në masën e 15 ditëve të punës, ose 17,955 lekë.

**6. F.R.** inxhinier mekanik, me detyrë përgjegjësi i sektorit të shërbimeve. gjobë në masën e 15 ditëve të punës, ose 28,850 lekë.

Pasi në prokurimin dhe marrjen në dorëzim të Projekt-Preventiv-zbatimi për rikonstruksionin e shtesë ambientesh për materninetin:

a) Nuk janë kontrolluar në se çmimet e manualeve të ndërtimit ishin ato të përcaktuara në VKM nr. 407, datë 27.06.2012” Për miratimin e çmimeve të ndërtimit”.

b) Nuk është kontrolluar Preventivi përfundimtar, i cili është paraqitur dhe marrë në dorëzim sipas akt marrjes datë 06.06.2013, pavarësisht se aty theksohet se projekti është kryer me cilësi dhe në

bazë të kërkesave nga DSHS Krujë. Preventivi nuk është hartuar sipas modularit TIP, pasi nuk ka ndarë më vete pajisjet, me qëllim që të mos tërhiqej TVSH.

c) Nuk kanë bërë hyrje në magazinë projekt-preventiv-zbatimin në vlerën 996,000 lekë.

**7. F.D.** me detyrë ekonomiste e pagave, në cilësinë e anëtares së komisionit të blerjeve në vlera të vogla, për 2 vitet 2009-2010, gjobë në masën e 15 ditëve të punës ose 18,125 lekë, pasi:

Ka lejuar dhe kryer pagesa të kundërligjshme për z. L.V. nëndrejtor ekonomik i Spitalit Krujë, pasi për një periudhë prej 23 muajsh paga është përlllogaritur padrejtësisht me nivelin e arsimit të lartë, dhe pa urdhër të brendshëm nga titullari për pagën dhe kategorinë apo klasën, duke shkaktuar një dëm ekonomik për vlerën 484,080 lekë.

**8. F.M.** me detyrë llogaritëse-arkëtare, në cilësinë e anëtares së komisionit të blerjeve në vlera të vogla, për 2 vitet 2009-2010, gjobë në masën e 15 ditëve të punës ose 18,125 lekë.

a) Për medikamentet mjekësore të blera në vitet 2009-2010 të cilat nuk janë të shoqëruar me dokumente si: serinë e barit, përmasat, paketimin, përshkrimi i plotë i barit, data e skadencës, fabrika prodhuese. Në 200 barna nuk është shënuar formëdoza e plotë, duke lënë shteg për abuzime, pasi për barnat me formëdoza të ndryshme, origjinë dhe prodhues të ndryshëm, edhe çmimi është i ndryshëm.

b) Për blerjen e medikamenteve me blerje të vogla, nga ana e komisionit, nuk është bërë ndarja e marzhit, pasi nga operatorët ekonomikë nuk kanë paraqitur dokumentacionin e regjistrimit të tyre, për të përcaktuar Statusin e operatorëve në cilësinë e importuesit apo shpërndarësit.

c) Në mjaft blerje të barnave me vlera të vogla, pavarësisht se janë marrë 3 oferta, çmimet janë më të larta nga vlera e tregut, më një rritje prej deri në 45%.

## **D. MASA ADMINISTRATIVE**

Mbështetur në nenet 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, pikës 3, kreu X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, neni 7, pika 2,3/a, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, është rekomanduar Drejtori i Agjencisë së Prokurimit Publik, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë), apo rekomandimin e autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për:

### **D.I. Për anëtarët e Komisionit të Vlerësimit Ofertave**

**1. F.R.** me detyrë, shefi i shërbimeve, specialist inxhinier mekanik në cilësinë e kryetarit të KVO,

**2. H.M.** me detyrë Përgjegjëse e sektorit të Financës në cilësinë e anëtares së KVO.

**3. F.M.** me detyrë arkëtare, në cilësinë e anëtares së KVO.

Në tenderin me objekt: “Blerje materiale mjekimi”, me fond limit 800,000 lekë me t.v.sh. shoqëria e shpallur fituese nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit, të miratuara dhe Dokumentet Standard të tenderit pasi mungon *certifikata e gjendjes financiare, nuk janë paraqitur mostrat për çdo produkt të ofruar, dëshmia e origjinalitetit të mostrave si dhe nuk ishte depozituar deklarata e konfliktit të interesave*, nuk duhej të shpallej fitues Operatori ekonomik “F...A” sh.p.k.

### **D.II. Hartuesit e dokumenteve të tenderit**

**1. A.P.** me detyrë Jurist,

**2. A.D.** me detyrë teknik ndërtimi në Spitalin Krujë

**3. F.R.** me detyrë inxhinier mekanik, me detyrë përgjegjës i sektorit të shërbimeve.

### **D.III. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit Ofertave**

**1. D.H.** me detyrë ish nëndrejtor ekonomik, aktualisht nuk punon në Spital.

**2. A.T.** me detyrë inxhinier Hidroteknik, i punësuar me kontratë si specialist i jashtëm.

**3. N.N.** me detyrë inxhinier Ndërtimi, i punësuar me kontratë si specialist i jashtëm.

Në tenderin “Projekt-Preventiv-zbatimi për rikonstruksionin e shtesë ambjentesh për maternitetin e Spitalit Krujë”, Operatori ekonomik “K...N” sh.p.k i shpallur fitues nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit, të miratuara dhe Dokumentet Standard të tenderit.

**D.IV.** Mbështetur në nenin 5/b të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për Inspektimin e Ndërtimit", i ndryshuar dhe nenin 15 "Sanksionet", të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", është rekomanduar Kryeinspektori i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative, (dënimin me gjobë) për:

**1.K.H. dhe E.H.** drejtues ligjor dhe drejtues teknik të Shoqërisë, Projektim "K...N", për mos hartimin me cilësi të projekt-preventivit të prokurimit; përfshirjen në preventivin përfundimtar edhe vlera e pajisjeve së bashku me TVSH, duke rritur artificialisht vlerën e preventivit; si dhe moshartimin e tij sipas modularit TIP, pasi nuk ka ndarë më vete pajisjet, me qëllim që vlera e tyre të përjashtohet nga llogaritja e TVSH.

## **F. KALLZIM PENAL**

**Bazuar në ligjin nr. 7905, datë 21.03.1995 "Kodi i Procedurës Penale i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 281, me shkresën nr. 732/16, datë 31.12.2013 kemi bërë kallëzim penal duke dërguar për veprime të mëtejshme procedurale në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, z. L.V., me detyrë nëndrejtor ekonomik i DSHS Krujë.**

Ka lejuar të kryhej pagesë e kundërligjshme për veten e tij, në cilësinë e nëndrejtorit të Spitalit Krujë, për një periudhë prej 23 muajsh, duke përlloritur padrejtësisht pagën me nivelin e arsimit të lartë, ndërkohë që nuk ishte diplomuar.

Ka kryer blerje në vlera të vogla për periudhën e viteve 2009-2010 për 360 medikamente mjekësore në vlerën 7,776,606 lekë, ndërkohë që nuk ishin parashikuar nevojat të shoqëruara me listat për llojet e medikamenteve apo grup mallrave dhe nuk ishte dërguar për botim në APP.

b) Ka kryer blerje në vlera të vogla në kapërcim të shumës kufi për periudhën e 2 viteve 2009-2010, për 360 medikamente mjekësore në vlerën 7,776,606 lekë.

c) Nuk ka argumentuar fondin limit, për blerjet e vogla.

ç) Në komisionin e blerjeve në vlera të vogla, të medikamenteve të mjekimit nuk është caktuar specialist i fushës, mjek, apo infermier.

d) Nuk ka ngritur komision dhe nuk janë hartuar procesverbalet e marrjes në dorëzim të medikamenteve mjekësore, për vitet 2009-2010 për 360 barna në vlerën prej 7,776,606 lekë. Blerja e tyre është bërë pa u shoqëruar me dokumentin përkatës, lidhur me serinë e barit, përmasat, paketimin, përshkrimin e plotë të barit, data e skadencës, fabrika prodhuese, etj. Në 200 barna në procesverbalet e blerjes dhe fletë hyrjet e farmacisë, nuk është shënuar formëdoza e plotë, duke lënë shteg për abuzime, pasi barnat me formëdoza të ndryshme, origjinë dhe prodhues të ndryshëm kanë çmime të ndryshme.

dh) Për blerjen e medikamenteve, nuk është bërë ndarja e marzhit, pasi nga operatorët ekonomikë nuk janë paraqitur dokumentacionet e regjistrimit të tyre, për të përcaktuar statusin e operatorëve në cilësinë e importuesit apo shpërndarësit.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Nga Spitali Krujë janë pranuar e vënë në zbatim rekomandimet e KLSH dhe është dërguar Plan masash për zbatimin e tyre me shkresë të protokolluar në KLSH nr. 732/19 datë 14.01.2014, pra rezulton se **rekomandimet janë pranuar**, dhe janë në marrë masat për zbatimin e tyre.

*Shënim:* Auditimi është kryer nga audituesit Niko Nako, Hodo Hasani, Rajmondi Koçi dhe Irma Shkupi, më tej u shqyrtua nga z. Fatmir Zilja kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i

Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

## **KONTROLI I LARTË I SHTETIT**